

## **Kodi i Etikës për Studentët në Shkëmbim (Në ardhje/Incoming dhe në shkuarje/ Outgoing)**

### **1. Respektimi i Vlerave dhe Rregulloreve të Institucionit**

Studentët që marrin pjesë në programin e shkëmbimit duhet të respektojnë vlerat, rregullat dhe politikat e institucioneve përkatëse (Institucionit mikpritës dhe institucionit dërgues). Kjo përfshin integritetin akademik, disiplinën dhe sjelljen në përputhje me pritshmëritë e institucioneve.

### **2. Integriteti Akademik**

Studentët pritet të mbajnë standardet më të larta të integritetit akademik. Kjo përfshin:

- Të shmangin plagjiaturën, mashtrimet dhe çdo formë tjetër të pandershmerisë akademike.
- Të respektojnë afatet për detyra, provime dhe kërkesa të tjera akademike.
- Të nderojnë marrëveshjet që janë bërë në Marrëveshjen e Mësimi (Learning Agreement), dhe të përfundojnë kurset dhe projektet me ndershmëri dhe me angazhim të plotë.

### **3. Respektimi i Diversitetit dhe Ndërgjegjësimi Kulturor**

- Studentët duhet të tregojnë respekt për diversitetin dhe kulturat që janë të pranishme në institucionin pritës, duke qenë të hapur dhe tolerantë ndaj dallimeve/ndryshimeve.
- Ata duhet të jenë të vetëdijshëm për normat, vlerat dhe traditat kulturore që mund të ndryshojnë nga ato të tyre dhe të tregojnë respekt për komunitetin dhe individët në vendin pritës.

### **4. Sjellja dhe Dëgjueshmëria**

**Studentët pritet të:**

- Mbajnë një qëndrim profesional dhe respektues si brenda, ashtu edhe jashtë klasës.
- Shmangin sjelljet e papëlqyera, ofenduese ose të papranueshme në kontekstin akademik, social dhe kulturor.
- Respektojnë ligjet vendore, zakonet dhe politikat e vendit pritës dhe të adaptohen me mjedisin akademik.

### **5. Komunikimi dhe Bashkëpunimi**

- Studentët duhet të angazhohen në komunikim efektiv dhe respektues me profesorët, stafin dhe studentët e tjerë.

- Ata duhet të marrin pjesë aktivisht në projekte grupore, diskutime dhe aktivitete akademike.
- Nëse paraqitet ndonjë problem, studentët inkurajohen të komunikojnë me zyrën ndërkombëtare ose këshilltarin akademik me kohë.

## **6. Saktësia dhe Pjesëmarrja**

- Studentët pritet të jenë të pranishëm dhe të jenë në kohë për mësim, takime dhe angazhime të tjera.
- Pjesëmarrja është e detyrueshme përveç nëse justifikohet nga arsye legjitime (siç është sëmundja ose një emergjencë), dhe studentët janë përgjegjës për të mbajtur ritmin me punën e tyre akademike nëse humbasin ndonjë ligjeratë apo detyrim gjatë mëimit.

## **7. Respektimi i Mjedisit dhe I pajisjeve të Kampusit**

- Studentët duhet të respektojnë mjedisin fizik të institucionit pritës, duke përfshirë klasat, bibliotekën, zonat e studimit dhe fasilitetet e tjera.
- Duhet të kujdesen për kampusin dhe hapësirat publike, duke mbajtur pastërtinë dhe duke respektuar resurset e përbashkëta.

## **8. Konfidencialiteti dhe Mbrojtja e Të Dhënave**

- Studentët duhet të ruajnë konfidencialitetin dhe privatësinë në të gjitha çështjet akademike dhe personale.
- Ata duhet të respektojnë ligjet dhe rregullat e mbrojtjes së të dhënave, duke siguruar që çdo informacion personal ose akademik të mbetet i sigurt dhe privat.

## **9. Përshtatshmëria në Aktivitetet Sociale**

- Studentët duhet të marrin pjesë në aktivitete sociale në një mënyrë që promovon respektin dhe përfshirjen, duke shmangur çdo sjellje që mund të konsiderohet ofenduese ose e dëmshme për të tjerët.
- Ata duhet të përfaqësojnë institucionet e tyre (atë pritës dhe dërgues) në mënyrë pozitive në ndërveprimet sociale, duke promovuar shkëmbimin kulturor dhe mirëkuptimin e ndërsjellë.

## **10. Angazhimi në Programin e Shkëmbimit dhe Suksesin Akademik**

- Studentët në shkëmbim duhet të përpiqen të arrijnë qëllimet e tyre akademike dhe të shfrytëzojnë sa më shumë mundësi nga koha e kaluar në institucionin pritës.

- Ata duhet t'i informojnë të dy institucionet (atë dërgues dhe pritës) për çdo ndryshim në pjesëmarrjen e tyre, shëndetin ose situatat personale që mund të ndikojnë në aftësinë e tyre për të përmbushur kërkesat akademike ose të programit.

#### **11. Feedback dhe Reflektim**

- Studentët duhet të reflektojnë mbi përvojën e tyre të shkëmbimit dhe të kontribuojnë me feedback që mund të ndihmojë në përmirësimin e programit të shkëmbimit për pjesëmarrësit e ardhshëm.
- Ata priten të dorëzojnë çdo raport ose dokumentacion të kërkuar në lidhje me përvojën e tyre të shkëmbimit dhe të ofrojnë feedback të dobishëm për të dy institucionet.